



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr.265 , datë 05.02. 2013

“Mbi

vendosje gjobe ndaj shoqërisë Viloil Sh.A për mosnjoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Viloil Sh.A nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar, nga shoqëria “City Investement Holding S.A”, tek aksioneret z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”

Komisioni i Konkurrencës me perberjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Znj. Rezana Konomi Zv. Kyetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Iva Zajmi Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 05.02.2013, me pjesmarrjen e Znj. Lindita Milo (Lati) kryetar, Znj. Rezana Konomi , zv. Kyetar, Znj. Servete Gruda, anëtar, Znj. Iva Zajmi, anëtar; shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Vendosjen e gjobës së lehtë për kundravajtje administrative ndaj shoqërisë Viloil Sh.A për mosnjoftim të përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar, nga shoqëria “City Investement Holding S.A”, tek aksioneret z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, neni 73

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretares së Përgjithshme mbi mos-njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar, nga shoqëria “City Investement Holding S.A”, tek aksionerët z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”.

V Ë R E N S E:

I. Procedura e ndjekur

Përqendrimi është realizuar në bazë të “Marrëveshjes për Blerjen e Aksioneve” e nënshkruar midis palëve shoqëria ‘City Investement Holding S.A’ dhe aksionereve (të shoqërisë Viloil Sh.a) z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko, me datë 4 Shkurt 2012, me objekt përfitim e kontrollit të shoqërisë Viloil Sh.a, nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar nga shoqëria City Investement Holding S.A tek aksioneret z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko. Këta të fundit do të zotërojnë shoqërinë target në masën prej 50% të aksioneve seicili.

Përqëndrimi nuk është njoftuar brenda afatit 30 ditorë të parashikuar në nenin 12, pika 2 dhe për këtë arsye Komisioni i Konkurrencës e ka filluar procedurën me nismën e tij me vendimin Nr. 250 , datë 20.11. 2012 “Mbi hapjen e procedurës së kontrollit të përqendrimit si rezultat i transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë Viloil Sh.a, nga shoqëria City Investement Holding S.A, tek aksioneret z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”.

II. Njoftimi i përqendrimit pas vendimit të Komisionit

Pas njohjes me vendimin e Komisionit, pala përfituese ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës formularin e thjeshtuar të përqendrimit dhe dokumentacionin shoqërues. Me sigurimin e të dhënave, Autoriteti i Konkurrencës, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, me shkresën Nr. 592/5 Prot. datë 09.01.2013, (i) njoftoi palën për fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimit në përputhje me nenin 54 të Ligjit.

III. Konkluzione

Mosnjoftimi i përqendrimit në kuptim të nenit 73, pika 1 germa dhe të Ligjit vlerësohet si kundravajtje administrative dhe për këtë arsye i propozoj Komisionit të Konkurrencës vendosjen e një gjobe për shkelje të lehtë.

Ky transaksion i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në ndërmarrjen Viloil Sh.a në formën e zvogëlimit të numrit të aksionerëve nuk sjell ndryshime strukturore në treg pasi nuk ndryshon indeksi i përqendrimit të tregut dhe për pasojë nuk jemi para rastit të parashikuar në nenin 74, pika 1. Germa d pasi përqëndrimi nuk ka efekte të kufizimit të konkurrencës në treg.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 24, (shkronja d); nenit 12, pika 2, nenit 53, pika 1, germa a, nenit 73, pika 1, germa dh e Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,(i ndryshuar), dhe nenit 12 të rregullores “Per gjobat dhe lehtesimin prej tyre”.

VENDOSI:

1. Të gjobisë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë ndërmarrjen Viloil Sh.A për mosnjoftimin e përqendrimit të realizuar.

2. Ngarkohet Sekretari i përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA
()
Anëtar

Koço BROKA
()
Anëtar

Iva ZAJMI
()
Anëtar

Rezana KONOMI
()
Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R